

Anketë për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale**- dhjetor 2024-**

Anketë për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen reale të PBB-së¹ për periudhën 2024 – 2026, e kryer në muajin dhjetor², nuk tregon në ndryshime të konsiderueshme të pritjeve për normën mesatare të inflacionit, ndërsa ndryshimet për rritjen e PBB-së janë mjaft më të larta. Analistët ekonomikë vazhdojnë të besojnë se ekziston një shkallë e lartë e pasigurisë për rrjedhën e ngjarjeve të ardhshme dhe i lidhin rreziqet më të mëdha me konfliktin ushtarak në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme, por edhe pasigurinë e shtuar të politikave tregtare dhe efektet që ndryshimi i klimës do të kishte. Megjithatë edhe në këtë anketim tregohet se ngadalësimi gradual i inflacionit, si dhe rritja e aktivitetit investues në periudhën e ardhshme, mund të kenë efekte pozitive në ekonominë vendase.


Sa i përket **inflacionit**, të anketuarit edhe më tej presin ngadalësimin e tij gradual. Kështu, për vitin 2024 është bërë një rishikim minimal në rënie (prej 0,1 p.p.) dhe tani ata presin një normë mesatare të inflacionit prej 3,5%, ndërsa për vitin 2025 dhe 2026 është bërë rishikim minimal në rritje (prej 0,1 p.p.) dhe të anketuarit presin një normë mesatare të inflacionit prej 3% për vitin 2025 dhe 2,5% për vitin 2026. Ngjashëm sikur deri tani, të anketuarit ende presin presione më të moderuara mbi inflacionin si rezultat i stabilizimit gradual të çmimeve të ushqimit dhe energjensave, ndërsa gjithashtu pritet që për ngadalësim të inflacionit të kontribuojnë edhe masat e marra nga bartësit e politikave, si dhe ngadalësimin e inflacionit të huaj. Faktorët që mund të shkaktojnë presione në rritje mbi inflacionin vazhdojnë të theksohen si kohëzgjatja dhe pasiguria që rrethon zgjidhjen e luftës në Ukrainë dhe konfliktin në Lindjen e Mesme, ndryshimet klimatike, që ndikojnë në çmimet e produkteve primare, dhe si një rrezik shtesë në këtë anketë vihet në dukje edhe pasiguria e shtuar e politikave tregtare, e cila mund të reflektojë në rritje të mëtejshme të barrierave tregtare. Gjithashtu, të anketuarit mendojnë se rritjet e mundshme të pagave si rezultat i zhvillimeve në tregun e punës, por edhe të pensioneve, si dhe përkeqësimet e mundshme të furnizimit me energji dhe rritjet e çmimeve në tregun e rregulluar mund të çojnë në presione të mundshme shtesë inflacioniste.

Në aspektin e **aktivitetit ekonomik**, te norma e pritshme e rritjes është bërë korrigjim i vogël në rritje. Kështu, të anketuarit presin rritje ekonomike prej 2,5% këtë vit (2,2% në anketën e mëparshme), 3,3% për vitin 2025 (3,1% në anketën e mëparshme), ndërsa për vitin 2026 pritet rritje prej 3,7%, njejtë sikur në anketën e mëparshme. Lidhur me faktorët që kontribuan në këto pritshmëri, të anketuarit mendojnë se stabilizimi gradual i inflacionit, ulja e nisur e normave të interesit të brendshëm dhe të huaj, si dhe rritja e pagave dhe pensioneve mund të kontribuojë në rritjen e konsumit dhe investimeve personale, të cilat do të reflektohet pozitivisht në rritjen ekonomike. Gjithashtu, të anketuarit presin rritje të investimeve të huaja dhe vendase, si dhe përshpejtim të zbatimit të projekteve të investimeve

¹ Në vitin 2017, Banka Popullore bëri ndryshim në hulumtimin e anketës "Anketa për pritjet inflacioniste", që është zbatuar në "Anketa për pritjet inflacioniste dhe pritjet për lëvizjen e PBB-së reale", struktura e re së cilës e monitoron pyetësorin tremujor për parashikuesit profesional (Quarterly Survey of Professional Forecasters, https://www.ecb.europa.eu/stats/ecb_surveys/survey_of_professional_forecasters/html/index.en.html), që e zbaton Banka Qendrore Europiane (BQE) dhe njëkohësisht e ndryshoi edhe strukturën e mostrës, që tani është i përbërë vetëm nga ekspertët ekonomik.




² Anketa u zbatua në periudhën prej 17 deri 24 dhjetor 2024.

publike, të lidhura kryesisht me infrastrukturën rrugore dhe sektorin energjetik, si dhe investimet private, të cilat do të mbështeten më tej nga kreditë e favorshme të shpallura për kompanitë. Nga ana tjetër, si faktorë që mund të ndikojnë negativisht në rritjen e ardhshme ekonomike, të anketuarit në këtë anketë theksojnë edhe përkeqësimin e perspektivës së rritjes së ekonomive të partnerëve kryesorë tregtarë, veçanërisht të Gjermanisë, pasigurinë për rrjedhën e ardhshme të luftës në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme, ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tij në zinxhirët e furnizimit dhe gjithashtu tregojnë për pasigurinë në rritje të politikave tregtare. Gjithashtu, të anketuarit vazhdojnë të përmendin pasigurinë në lidhje me rrjedhën e negociatave me BE-në si një faktor potencial që kufizon rritjen ekonomike në periudhën e ardhshme.






Në kuadër të Anketës, të anketuarit japin edhe mendimin e tyre për **shpërndarjen e probabilitetit për realizimin e normave të përcaktuara në interval të caktuar**. Këto vlerësime përdoren për krijimin e shpërndarjes agregate të probabiliteteve³. Shpërndarja agregate e probabiliteteve për realizimin e normave të dhëna të inflacionit dhe PBB në pesëmbëdhjetë intervale është shfaqur në grafikonët në vijim, dhe rezultatet kryesisht përputhen me normat që i presin të anketuarit.

³Shpërndarja agregate e probabiliteteve paraqet mesatare nga vlerësimet e të anketuarve për probabilitetet, për çdo interval të normës së pritshme të inflacionit dhe normës së rritjes së PBB-së.



Përsa i përket pritjeve të **normës së inflacionit**, shpërndarjet e probabilitetit për këtë dhe dy vitet e ardhshme tregojnë për zhvendosje drejt intervaleve më të ulëta dhe përqendrimit më të madh brenda dhe rreth intervaleve të pritshme të normës mesatare.



Kur bëhet fjalë për **normën e pritshme të PBB-së**, shpërndarja e probabilitetit për këtë dhe dy vitet e ardhshme tregon për zhvendosje drejt intervaleve më të larta dhe përqëndrimit më të madh brenda dhe rreth intervalit të normës mesatare të pritur.